



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ZONAVE TË MBROJTURA
DREJTORIA E MENAXHIMIT, PROJEKTEVE DHE MONITORIMIT

Nr. ____ prot

Tiranë me ____/02/2016

Lënda : Raport mbi analizën vjetore të punës AKZM-së.

Krijimi dhe organizimi i AKZM

AKZM-ja filloi organizimin e saj në mesin e marsit të vitit 2015 bazuar në VKM-në Nr. 102, datë 4.02.2015 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura” dhe Urdhërit të Kryeministrit Nr. 39, datë 12.03.2015 “Miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura”.

E gjithë veprimtaria e AKZM-së dhe AdZM-ve në qarqe bazohet në ligjin Nr. 8906, datë 6.06.2002 “Për zonat e mbrojtura” i ndryshuar, ligjin Nr. 9587, datë 20.07.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, ligjin e pyjeve, ligjin e gjuetisë, ligjin e kullotave, ligjin e mjedisit, ligjin e ndikimit në mjedis etj., në të gjitha aktet nënligjore që lidhen me këto ligje si dhe në Rregulloren e brendshme për menaxhimin monitorimin dhe funksionimin e zonave të mbrojtura.

Për përmbushjen e misionit të saj, ruajtjen dhe kujdesin ndaj natyrës e biodiversitetit, AKZM, nëpërmjet menaxhimit të rrejtë të zonave të mbrojtura në shkallë vendi, mbledhjes dhe shpërndarjes së informacionit, edukimit mjedisor dhe ndërgjegjësimit të publikut për zonat e mbrojtura dhe mbështetjes së aktiviteteve të qëndrueshme ekonomike brenda këtyre zonave, është përpjekur të kryejë me korrektesë e përkushtim të gjitha detyrat e ngarkuara sipas sektorëve.

AKZM dhe AdZM-të në qarqe gjatë periudhës mars- Dhjetor 2015 e ka përqëndruar punën e saj në këto drejtime:

i.Ristrukturimi dhe organizimi i administratës,

ii.inventarizimi i bazës materiale dhe teknike,

iii.forcimin e punës organizative dhe rritjes së kapaciteteve në drejtim të menaxhimit dhe monitorimit të ZM,

iv.promovimin e vlerave natyrore, biodiversitetit dhe edukimin **v.**identifikimin e inventarit të pyjeve dhe kullotave brenda ZM-ve,

vi.bashkëpunimin dhe kordinimin e veprimtarive edhe me aktorë të tjerë si AKM, AKPT, IKT të Ujit, MBZHR, AKBN, ISHMP, DRSHP-të, njësitë e qeverisjes vendore, Bashkitë e reja, OSHC, donator, projekte etj.

1. Detyrat dhe objektivat e realizuara .

Bazuar në programin e punës të AKZM-së për vitin 2015 si dhe në strategjinë kombëtare të zonave të mbrojtura, Drejtoria e menaxhimit, projekteve dhe monitorimit në AKZM dhe AdZM-të në qarqe organizuan punën në këto drejtime kryesore.

1. Për Administrimin dhe menaxhimin

Drejtoria e Menaxhimit, Projekteve dhe Monitorimit në bashkëpunim me AdZM-të në qarqe organizoi punën, në zbatim programit të punës hartuar për AKZM-në, Strategjisë Kombëtare për ZM-të, të Urdhrave të Ministrit të Mjedisit dhe Nr. 674, datë 26.08.2015 “Për transferimin pranë AKZM-së dhe AdZM-ve dokumentacionin teknik të arkivuara për zonat e mbrojtura nga Drejtoritë Rajonale të Shërbimit Pyjor në qarqe (DRSHP-të) dhe marrjes në dorëzim të biletave hyrëse për vizitorët” të detyrave që rrjedhin nga rregullorja e brendshme dhe detyrat specifike që ka çdo sektor.

- Është bërë grumbullimi i dokumentacionit teknik për menaxhimin e Zonave të Mbrojtura dhe aktiviteteve që zhvillohen në to.

- Transferimi i dokumentacionit nga DRSHP-të, si ekonomitë pyjore, planet e mbarështimit, të inventarizimit apo të menaxhimit që disponojnë për ekonomitë pyjore, hartat dixhitale për ekonomitë pyjore, skedat kadastrale, skedat e monumenteve të natyrës (MN), kontratat e lidhura me DRSHP-të etj si dhe dokumentacionin teknik që ka të bëjë me ZM.

Për realizimin e kësaj detyre u hartuan Urdhëra dhe Programe pune nga AdZM-të e qarqeve në bashkëpunim me DRSHP-të. Në përgjithësi kjo detyrë është realizuar, por ka dhe raste kur DRSHP-të nuk kanë përmbushur këtë urdhër, duke neglizhuar e mos iu përgjigjur kërkesave të AdZM-ve, siç është rasti i DRSHP-së Durrës dhe DRSHP-së Lezhë.

Drejtoria e Menaxhimit, Projekteve dhe Monitorimit në bashkëpunim me AdZM-të në qarqe organizoi punën për të realizuar detyrat si:

- Në bashkëpunim me ekspertin e GIS-it filloi puna për të saktësuar kufijtë natyror të zonave të mbrojtura, përputhja e tyre me sistemin e koordinatave, përcaktimi dhe saktësimi i zonimit të brendshëm, për ekosistemet dhe habitatet floristike dhe faunistike, punë e cila do të vazhdojë dhe gjatë këtij viti.

- Vazhdoi puna për sigurimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të shoqërive private që kryejnë aktivitete të ndryshme në territorin e Zonave të Mbrojtura (ZM).

- Organizoi punën për bashkëpunim ndërmjet AdZM-ve në qarqe për teknikën e trajtimit të pyjeve në Zonat e Mbrojtura, (kemi raste si në PK të Prespës, PK. Shebenik – Jabllanicë).

- Organizoi përpilimin e skedave kadastrale të ZM-ve (të cilat kanë nevojë për përditësim dhe gjatë këtij viti do të standartizojmë një model për të gjithë).

- Organizoi punën për hartimin dhe unifikimin e skedave standarte për Monumentet e Natyrës, detyrë të cilën e kanë përmbushur të gjithë qarqet me përjashtim të Qarkut Vlorë , i cili është akoma në proces për shkak të vështirësive që ka hasur në bërjen e fotove.

- AKZM-ja në të gjitha qarqet ka pasur bashkëpunim me OJQ dhe OJF të ndryshme mjedisore që operojnë sipas qarqeve përkatëse.

Drejtoria e Menaxhimit, Projekteve dhe Monitorimit në bashkëpunim me AdZM-të në qarqe organizoi punën për të realizuar detyra si:

- Raportin final për Skedat e (MN),

- Raportin për HEC-et që gjenden brenda (ZM)-ve
- Ndërtoi databasin për festat lokale për çdo qark,
- Ndërtoi databasin për ndërtimet pa leje që gjenden brenda (ZM)-ve
- Ndërtoi databasin për pikat turistike në ZM-të.
- Ndërtoi databasin për vatrat e mbetjeve, ndotjeve që gjenden në ZM.

Referuar të dhënave të mbledhura në database rezulton se:

Brenda rrjetit të ZM gjenden gjithsej 71 HEC-e, kontrolluar nga AdZM-të në qarqe, nga këto: HEC-e që kanë qënë ndërtuar para viteve 90-të janë 6 (gjashhtë), janë ndërtuar pas viteve 90-të dhe kanë filluar prodhimin 21 (njëzetënjë), janë në proces ndërtimi 44 (dyzetekatër). Vetëm në rrethin e Librazhdit janë ndërtuar e po ndërtohen gjithsej 40 HEC-e. Nisur nga shqetësimet dhe problematikat e dala për ndërtimin e HEC-eve, po punojmë në bashkëpunim me AKM-në për të qartësuar përfundimisht numurin e tyre dhe nëse janë pajisur me leje mjedisore apo jo. Jemi duke kryer një verifikim të saktë bazuar në kontratat e lidhura dhe sistemet e koordinatave, detyrë e cila do të përfundojë së shpejti.

Në rrjetin e ZM gjenden e zhvillohen dhe aktivitete të tjera si nxjerrje minerale (kromi), prodhime të inërteve (gurore), prodhime të pllakave të gurëve dekorativ etj. Nga kontrollet e kryera në terren nga AdZM-të konstatohet se kemi dëmtime të natyrës e mjedisit, subjektet nuk i përmbahen kushteve të lejes së mjedisit. Po punojmë ti vendosim nën kontroll të plotë, brenda standarteve dhe kushteve të lejeve mjedisore. Së shpejti do të bëhet një Raport i plotë në lidhje me këto aktivitete.

Gjatë kontrolleve të kryera nga AdZM dhe AKZM-ja rrezulton se brenda rrjetit të Zonave të Mbrojtura gjenden rreth 1200 ndërtime pa leje si:

- Shtëpi banimi, rreth 500, më shumë janë në qarkun e Shkodrës, të Fierit, Durrësit dhe Lezhës, dhe qarku që ka më shumë është qarku Shkodër me 325, Fieri 126 dhe Lezha 40
- Njësi shërbimesh, baraka, magazinë, resorse, lavazhe, servise, dhe çdo lloj shërbimi të tjera janë si më poshtë:
- Kjoska, druri janë rreth 29 gjithsej dhe 27 prej tyre janë në qarkun e Lezhës.
- Baraka, janë rreth 37 gjithsej, ku 12 janë në Durrës dhe 25 janë në qarkun e Lezhës.
- Bar-Bufe, janë rreth 32 gjithsej, ku 12 janë në Lezhë dhe 20 janë në qarkun e Vlorës.
- Lokale, janë 26 gjithsej dhe 25 prej tyre janë në qarkun e Vlorës.
- Lokal+ambjent, janë 13 gjithsej dhe janë në qarkun e Vlorës.
- Akuakulturë, janë 16 gjithsej dhe janë në qarkun e Vlorës.
- Antena, janë 8 gjithsej dhe ndodhen në qarkun e Vlorës.
- Kabina, gjithsej janë 10 dhe janë në qarkun e Shkodrës.
- Baxho, gjithsej 5 dhe janë në Elbasan.

Detyrë tjetër që është ndjekur me vëmendje është dhe përcaktimi i pikave të mbetjeve urbane, të ngurta, ujërave të zeza dhe industriale që ndodhen brenda rrjetit të zonave të mbrojtura. Gjatë kontrolleve të kryera nga AdZM-të për vitin 2015 janë konstatuar gjithsej 34 nga këto:

- urbane = 18
- të ngurta = 9

- ujëra të zeza = 3

- industriale = 4

AKZM-ja së bashku me AdZM-të kanë ushtruar kontrolle të vazhdueshme në këto vatra dhe ka konstatuar se në pikat e mbetjeve urbane shqetësuese është pastrimi i mbetjeve mbas kryerjes së aktiviteteve që organizohen në raste takimesh e festash, mbetet shqetësuese ndotja e sipërfaqeve nga mbetjet e ngurta sidomos në vendet që kryhen punime për HEC-et apo dhe rikonstruksione të ujësjellësave. Shqetësim ka dhe në PBUT – Pogradec, venddepozitimi i hekur nikelit në afërsi të Gurit të Kuq. Përsa i përket ndotjes nga ujrat e zeza shqetësuese është derdhja e ujrave nga banorët e fshatit Pustec e Goricë e vogël që ndodhet në Prespë. Nuk plotësojnë standartet, ndaj AdZM-ja qarku Korçë duhet të bashkëpunojë me Bashkinë e re për këtë problem, të kërkojë zgjidhjen e problemit.

Detyrë e rëndësishme ka qenë dhe mbetet në vijim verifikimi i gjendjes së florës dhe faunës brenda rrjetit të ZM. Gjendja e vegjetacionit është e mirë nuk kemi konstatuar raste të shfaqjes së sëmundjeve (fitopatologji) apo dëmtuesve (entomofage), dhe në ngastrat ku ka pasur zjarre në vitet e shkuara ka filluar të instalohet filizëri kjo do të bëjë të mundur dhe po rigjenerimin e sipërfaqeve të dëmtuara. Shqetësim është prania e insektit të procesonares te pyjet halor të llojit pishë.

Gjatë vitit 2015 puna është përqëndruar dhe në organizimin e veprimtarive të ndryshme për promovimin e vlerave të larta natyrore, mjedisore, kulturore, trashgimore, historike, fetare e tradicionale.

Janë organizuar seminare, takime dhe ëorkshope të ndryshme brenda dhe jashtë vendit:

AKZM-ja dhe AdZM-të kanë marrë pjesë dhe kanë bashkëpunuar me shumë shoqata ambientaliste, mjedisore si dhe me komunitetet në zona të ndryshme. Kanë qënë pjesëmarrëse në një sërë takimesh e konferenca të ndryshme.

Ka bashkëpunuar ngushtë me Projektin “Natyra 2000” “INCA”, “GIZ” “REC” “GEF” etj.

Ka marrë pjesë dhe në takime e seminare jashtë vendit si në Kosovë, për shkëmbim përvoja e experience (me Administratën e Parkut Rajonal të Sharrit, Rugovë), në Maqedoni (mavrovë).

Në kuadër të projektit “Financimi I kapaciteteve kombëtare për ruajtjen e natyrës – përgatitja me rrjetin Natyra 2000”, financuar nga Komisioni Evropian dhe zbatuar nga Cooperacioni Italian, Ministria e Jashme dhe bashkëpunimi Ndërkombëtar i Italisë në partneritet me (IUCN) dhe soqatën e botanistëve të Italisë (SBI).

Pjesëmarrëse në takim trajnues “Për vlerësimin paraprak të gjendjes aktuale të ZM në Shqipëri nëpërmjet përdorimit të Instrumentit të Vlerësimit të Efektivitetit të Menaxhimit (METT) që u zhvillua në Tiranë (Dajt) dhe vazhdoi në Vlorë.

Pjesëmarrje me dëgjuesën me publikun për zonimin e PK “Alpet e Shqipërisë”, organizuar nga MM, AKZM, GIZ, ECRAN.

Pjesëmarrëse në takimin kombëtar “Progresi në ruajtjen dhe menaxhimin e ZM në nivel kombëtar dhe vizitë në PKD Sazan – Karaburun organizuar nga AKZM, PNUD dhe GEF.

Pjesëmarrëse në takimin e organizuar në Prizren nga Qendra për Informim Turistik prizëren, mbështetur nga GIZ Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni për të diskutuar në lidhje me realizimin e projektit për hapjen e një shtegu turistik ndërkufitar I cili do të kalojë nëpërmjet të zonave të mbrojtura të tre shteteve duke filluar nga PK Shebenik – Jabllanicë, Korab – Koritnik dhe Sharrit.

Edukimi mjedisor ka qënë dhe mbetet një nga objektivat më të rëndësishme për AKZM dhe AdZM. I është kushtuar dhe do të kushtohet në të ardhmen vëmendje e veçant sidomos me fëmijët, pasi ato do të jenë ambasadorët e së ardhmes për mjedisin. Janë zhvilluar një sërë aktivitetesh pothuaj në të gjithë qarqet. Gjatë vitit 2015 AKZM nën moton që ZM nuk janë reparte ushtarake, të mbyllura të pakalueshme por shërbejnë si qendra të rëndësishme turistike, argëtuese, çlodhëse dhe promovuese për vlerat e larta natyrore, mjedisore, kulturore, historike e fetare.

Gjatë vitit 2015 në këto pika ka patur një numër të konsiderueshëm vizitorësh vendas dhe të huaj. Kështu në PK Lugina e Valbonës, PK Butrint, Theth, Dajt, Divjakë – Karavasta, Velipojë, Syri I Kaltër etj. Ka patur vizitorë ditor dhe të akomoduar.

AKZM synon që rrisë e shtojë zona të reja për tu futur në rrjetin e ZM, kështu ka zhvilluar takime me publikun për zonën e Porto – Palermos – Allamanaj dhe për masivin e Gështenjës në Tropojë.

Po kështu dhe parqet rajonale ka paraqitur dhe promovuar një sërë aktivitetesh si në Zagori – Gjirokastrë, Shkrel – Shkodër, Kthell – Mirditë.

II Monitorimi i ZM.

Spektori i monitorimit në bashkëpunim me Sektorët e Menaxhimit, Projekteve hartoi dhe përgatiti setin e evidencave mujore dhe progresive;

-Proces verbalin e konstatimit të dëmit në zonat e mbrojtura,

-Proces verbalin e regjistrimit të rënies së zjarrit në zonat e mbrojtura dhe me miratimin e Drejtorit të Përgjithshëm është bërë shpërndarja në AdZM-të e qarqeve për zbatim.

-Pëgatiti draftin e akt-marrëveshjes mes AKZM-së dhe ISHMP-së në lidhje me mirëfunksionimin e punës midis dy institucioneve, e cila pritet të miratohet nga ISHMP-ja.

Në mbështetje të të gjithave të dhënave të ardhura nga AdZM-të e qarqeve, në bazë të plotësimit të dokumentacionit të dërguar nga Spektori i Monitorimit në AKZM, është krijuar database kryesor për të gjitha AdZM-të e qarqeve, ku janë të regjistruara të gjitha proces verbalët e konstatimit të dëmeve, të zjarreve në zonat e mbrojtura si dhe problematikat e tjera të konstatuara nga sektorët e monitorimit në AdZM-të e qarqeve.

Kjo praktikë pune është monitoruar nga Spektori i Monitorimit në AKZM-në për çdo fund muaji, ku është bërë adresimi i të gjitha problematikave për të ardhmen, për zgjidhjen e tyre.

Të gjitha proces-verbalet e konstatimit të dëmit në zonat e mbrojtura, të mbajtura nga rojet mjedisore në AdZM-të e qarqeve ku një kopje është dorëzuar pranë ISHMP-së Rajonale, një kopje e ardhur pranë Sektorit të Monitorimit në AKZM-në, me shkresë zyrtare është dërguar për çdo muaj pranë ISHMP-së Qendror për ndjekjen e procedurave të tjera ligjore, kopetencë e të cilave është ISHMP-ja.

Në kuadër të bashkëpunimit të punës në mes AKZM-së dhe ISHMP-së në mënyrë sa më korrekte, në përmbushje të detyrave në lidhje me mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit, si dhe prerjeve të paligjshme në pyje në ZM, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Spektori i Monitorimit duke filluar nga muaji Mars-Dhjetor 2015 ju ka dërguar kopje të të gjitha proces-verbaleve të konstatimit të dëmeve në ZM mbajtura nga ana e AdZM-ve në qarqe.

Deri tani nuk kemi asnjë informacion mbi ecurinë e procedurave të ndjekura nga ana e ISHMP në lidhje me këto proces-verbale, gjë e cila do të na mundësonte ndjekjen e mëtejshme të procedurave nga ana e AKZM-së.

Me ardhjen e stinës së Verës, Spektori i Monitorimit në AKZM-në ka kërkuar nga të gjithë AdZM-të e qarqeve që në bashkëpunim me pushtetin vendor dhe me institucionet e tjera, marrjen e masave mbrojtëse për parandalimin e zjarreve në pyje dhe kullota në zonat e mbrojtura si :

1. Ngritja e Sistemit të vrojtimit sinjalizimit për parandalimin e rënies së zjarreve në zonat e mbrojtura.
2. Skema dhe grafikët të skuadrave zjarrfikse të AdZM-ve në qarqe në bashkëpunim me pushtetin vendor.

Gjatë gjithë periudhës së vitit 2015 në Sektorin e Monitorimit pranë AKZM-së janë regjistruar 280 Proces-verbale të konstatimit të demit në zonat e mbrojtura të ndarë sipas qarqeve:

Qarku Tiranë për vitin 2015 numri i proces verbaleve të mbajtura janë 30 raste gjithsej, me autor 8 raste, të ndarë sipas zërave;

- a. Pemë të prera në fondin pyjor janë konstatuar 17 raste me një numër 799 copë.
 - 7 raste të mbajtura në PK “Mali I Dajtit”
 - 10 raste në PM “mali me gropa Bizë Martanesh”
- b. Zaptim të fondit pyjor është konstatuar 1 rast me një sipërfaqe 250 m².
 - 1 rast në PK “Divjakë Karavasta”
- c. Gërmim pa leje në fondit pyjor janë konstatuar 8 raste me një sipërfaqe 9900 m².
 - 6 raste të mbajtura në PK “Mali I Dajtit”
 - 2 raste në PM “mali me gropa Bizë Martanesh”
- d. Rënie zjarri janë konstatuar 2 raste me një sipërfaqe të përkrahur 108.36 Ha
 - 2 raste të mbajtura në PK “Mali I Dajtit”

Qarku Berat për vitin 2015 numri i proces verbaleve të mbajtura janë **5 raste me autor** të ndarë sipas zërave

- a. Nxjerrje pllaka guri në karrieret e gurit dhe janë konstatuar 5 raste me një sipërfaqe 62 m².
 - 5 raste të mbajtura në PK “mali i Tomorrit”

Qarku Dibër për vitin 2015 numri i proces verbaleve të mbajtura janë autor **31 raste pa autor** të ndarë sipas zërave

- a. Pemë të prera në fondin pyjor janë konstatuar 28 raste me një numër 2171 copë.
 - 18 raste në PM “mali me gropa Bizë Martanesh”
 - 5 raste PN “Korab-Koretnik
 - 4 raste në ZMBM Lumzi Bulac
 - 1 rast në Pk ‘Lurë”
- b. Rënie zjarri janë konstatuar 3 raste me një sipërfaqe të përkrahur 29 Ha
 - 1 rast në PM “mali me gropa Bizë Martanesh”
 - 1 rast PN “Korab-Koretnik
 - 1 rast në ZMBM Lumzi Bulac

Qarku Durrës për vitin 2015 numri i proces verbaleve të mbajtura janë 13 raste gjithsej **3 raste me autor**, të ndarë sipas zërave

- a. Pemë të prera në fondin pyjor janë konstatuar 11 raste me një numër 163 copë.
 - 3 raste të mbajtura në PK “Mali I Dajtit”
 - 8 raste të mbajtura në PK “Qaf-shtamë”
- b. Zaptim të fondit pyjor është konstatuar 1 rast me një sipërfaqe 129 m².
 - 1 rast të mbajtura në PK “Qaf-shtamë”
- c. Rënie zjarri janë konstatuar 1 rast me një sipërfaqe të përkrahur 15 Ha

- 1 rast të mbajtura në PK “Qaf-shtamë”

Qarku Elbasan për vitin 2015 numri i proces verbaleve të mbajtura janë 40 raste gjithsej **10 raste me autor**, të ndarë sipas zërave

- a. Pemë të prera në fondin pyjor janë konstatuar 32 raste me një numër 239 copë.
 - 29 raste në Pk ‘Shebenik Jabllanicë’
 - 2 raste në RNM ‘Stravaj’
 - 1 raste në RNM ‘Dadh- Xhyrë’
- b. Kullotje pa leje janë konstatuar 5 raste me një numër 750 krerë.
 - 5 raste në Pk ‘Shebenik Jabllanicë’
- c. Gjueti e paligjshme është konstatuar 1 rast.
 - 1 raste në Pk ‘Shebenik Jabllanicë’
- d. Rënie zjarri janë konstatuar 2 raste me një sipërfaqe të përkthuar 60 Ha
 - 1 raste në Pk ‘Shebenik Jabllanicë’
 - 1 raste në RNM ‘Stravaj’

Qarku Fier për vitin 2015 numri i proces verbaleve të mbajtura janë 22 raste gjithsej **9 raste me autor** të ndarë sipas zërave

- a. Pemë të prera në fondin pyjor janë konstatuar 8 raste me një numër 451 copë.
 - 3 raste në PK “Divjakë Karavasta”
 - 4 rast në RNM “Pishë- Poro”
 - 1 raste në MN “ Rrepet e Pocemit”
- b. Zaptim të fondit pyjor janë konstatuar 2 raste me një sipërfaqe 1.35 Ha.
 - 2 raste në PK “Divjakë Karavasta”
- c. Ndërtim pa leje në fondit pyjor janë konstatuar 3 raste me një sipërfaqe 142 m2.
 - 3 raste në PK “Divjakë Karavasta”
- d. Rënie zjarri është konstatuar 1 rast.
 - 1 rast në PK “Divjakë Karavasta”
- e. Gjueti e paligjshme është konstatuar 1 rast.
 - 1 rast në PK “Divjakë Karavasta”
- f. Depozitim të mbetjeve urbane janë konstatuar 8 raste
 - 7 raste në PK “Divjakë Karavasta”
 - 1 rast në RNM “Pishë- Poro”

Qarku Gjirokastrë për vitin 2015 ka patur vetëm një rast zjarri me sipërfaqe të përkthuar 0.2 Ha. Në PK”Bredhi I Hotovës-Dangëlli”

Qarku Korçë për vitin 2015 numri i proces verbaleve të mbajtura janë 41 gjithsej **11 raste me autor**, të ndarë sipas zërave

- a. Pemë të prera në fondin pyjor janë konstatuar 20 raste me një numër 234 copë.
 - 5 raste në PK “Prespë”
 - 2 raste në PK “Bredhi I Drenovës”
 - 1 rast në RNM “Cangoj”
 - 5 raste ZBBM “Guri i Nikës”
 - 5 raste në RNM “Nikolicë”

- 1 rast në MN “Liqenet e Lenës”
 - 1 rast në PK “Bredhi I Drenovës”
- b. Transport i paligjshëm të materialit drusor janë konstatuar 6 raste.
- 4 raste në PK “Prespë”
 - 2 raste në MN “Pylli I Fazanëve”
- c. Ndërtim pa leje në fondit pyjor janë konstatuar 2 raste me një sipërfaqe 240 m².
- 1 rast ZBBM “Guri i Nikës”
 - 1 rast ZBBM “Guri i Nikës”
- d. Gërmim pa leje në fondit pyjor janë konstatuar 2 raste me një sipërfaqe 1400 m².
- 2 raste ZBBM “Guri i Nikës”
 - 1 rast në PK “Bredhi I Drenovës”
- e. Rënie zjarri janë konstatuar 2 raste me një sipërfaqe të përkrahur 25 Ha.
- 1 rast ZBBM “Guri i Nikës”
 - 1 rast PM “Liqeni I Pogradecit”
- f. Peshkim i paligjshëm janë konstatuar 9 raste.
- 9 raste në PK “Prespë”

Qarku Kukës për vitin 2015 numri i proces verbaleve të mbajtura janë 25 raste gjithsej **3 raste me autor**, të ndarë sipas zërave

- a. Pemë të prera në fondin pyjor janë konstatuar 15 raste me një numër 428 copë.
- 4 raste PK” Valbonë”
 - 3 raste RSN “Lumi I Gashit”
 - 4 raste PN “Korab-Koretnik
 - 4 raste në “Tej Drini i Bardhë”
- b. Zaptim të fondit pyjor është konstatuar 1 rast me një sipërfaqe 150 m²
- 1 raste PK” Valbonë”
- c. Dëmtime natyrore të pemëve pyjore të llojit Ah janë konstatuar 2 raste me një numër 700 copë.
- 1 raste RSN “Lumi I Gashit”
 - 1 raste PK” Valbonë”
- d. Rënie zjarri janë konstatuar 7 raste me një sipërfaqe të përkrahur 160 Ha.
- 5 raste PK” Valbonë”
 - 1 raste në “Tej Drini i Bardhë”
 - 1 raste PN “Korab-Koretnik

Qarku Shkodër për vitin 2015 numri i proces verbaleve të mbajtura janë 13 gjithsej **2 raste me autor** të ndarë sipas zërave

- a. Pemë të prera në fondin pyjor janë konstatuar 3 raste me një numër 10 copë.
- 2 raste RNM lumi Buna Velipojë
 - 1 rast në RNM “Liqeni I Shkodrës”
- b. Gërmim pa leje në fondit pyjor është konstatuar 1 rast me një sipërfaqe 2800 m².
- 1 rast RNM lumi Buna Velipojë
- c. Rënie zjarri janë konstatuar 5 raste me një sipërfaqe të përkrahur 4.5 Ha.
- 2 raste në RNM “Liqeni I Shkodrës”

- 2 RNM lumi Buna Velipojë
 - 1 raste PK ” Theth”
- d. Gjueti e paligjshme janë konstatuar 3 raste.
- 3 raste ne RNM “Liqeni I Shkodrës”
- e. Hedhje mbeturinash në zonë të mbrojtur është konstatuar 1 rast me një volum 10 m3.
- 1 rast PK ” Theth”

Qarku Lezhë për vitin 2015 numri i proces verbaleve të mbajtura janë 24 raste gjithsej **11 raste me autor** të ndarë sipas zërave

- a. Pemë të prera në fondin pyjor janë konstatuar 8 raste me një numër 53 copë.
- 5 raste RNM “Kune-Vain-Tale”
 - 1 rast RNM “Berzane”
 - 2 raste RNM “Patok-Fushkuqe- Ishëm”
- b. Kullotje pa leje janë konstatuar 3 raste me një numër 72 krerë.
- 3 raste RNM “Kune-Vain-Tale”
- c. Gjueti e paligjshme është konstatuar 1 rast.
- 1 rast RNM “Kune-Vain-Tale”
- d. Rënie zjarri është konstatuar i rast me një sipërfaqe të përkthuar 0.7 Ha
- 1 rast RNM “Kune-Vain-Tale”
- e. Vendosje bilançi janë konstatuar 7 raste.
- 7 raste RNM “Kune-Vain-Tale”
- f. Hedhje mbeturinash në zonë të mbrojtur është konstatuar 1 rast.
- 1 rast RNM “Kune-Vain-Tale”
- g. Ndërtim pa leje në fondit pyjor janë konstatuar 1 rast.
- 1 rast RNM “Patok-Fushkuqe- Ishëm”
- h. Bllokim mjëti peshkimi 1 rast
- 1 rast RNM “Kune-Vain-Tale”

Qarku Vlorë për vitin 2015 numri i proces verbaleve të mbajtura janë 34 gjithsej **5 raste me autor**, të ndarë sipas zërave;

- a. Pemë të prera në fondin pyjor është konstatuar 1 rast me një volum 5 mst.
- 1 rast në RNM “Rrëzomë”
- b. Gërmim pa leje në fondit pyjor janë konstatuar 2 raste me një sipërfaqe 1500 m2.
- 1 rast në PK ” Butrint”
 - 1 rast në PM Vjosë Nartë
- c. Dëmtime natyrore të pemëve pyjore janë konstatuar 5 raste me një numër 105 copë.
- 4 raste në PM Vjosë Nartë
 - 1 rast në RNM “Karaburun”
- d. Ndërtim pa leje në fondit pyjor janë konstatuar 4 raste me një sipërfaqe 50 m2.
- 2 raste në RNM “Karaburun”
 - 2 raste në RNM “Rrëzomë”
 - 1 rast në PK “Ilogara”
- e. Rënie zjarri janë konstatuar 16 raste me një sipërfaqe të përkthuar 64 Ha.
- 9 raste në RNM “Karaburun”

- 4 raste në PM Vjosë Nartë
 - 2 raste në RNM “Rrëzomë”
 - 1 rast në PK ” Butrint”
- f. Kullotje pa leje janë konstatuar 2 raste me një numër 140 krerë.
- 2 raste në RNM “Rrëzomë”
- g. Zënie të fondit kullosor është konstatuar 1 rast me një sipërfaqe 70 m2.
- 1 raste në RNM “Karaburun”
- h. Hedhje mbeturinash në zonë të mbrojtur janë konstatuar 3 raste.
- 1 rast në PK “Ilogara”
 - 1 rast në PK ” Butrint”
 - 1 rast në PM Vjosë Nartë
- i. Nxjerrje gurësh dhe zhavorri në zonë të mbrojtur është konstatuar 1 rast me një sipërfaqe 315 m2
- 1 rast në PM Vjosë Nartë

Si përfundim 67 proces-verbale konstatimi të mbajtura nga rojet mjedisore në AdZM-të e qarqeve, janë me autor dëmi, të cilat janë nisur ISHMP-ve për ndjekjen e mëtejshme të procedurave.

Problematika

Po kështu në lidhje me dërgimin e informacioneve nga AdZM-të e rretheve të ardhura pranë sektorit të monitorimit në AKZM, për disa qarqe jo vetëm është sjellë me vonesë por dhe jo i saktë ku numri i proces-verbaleve të mbajtura nuk rekodon me ato të pasqyruar në informacionet përkatëse, mund të përmendim AdZM-ja Durrës, Vlorë, Shkodër, Girokastër.

Kanë qenë më korrekte AdZM-të Elbasan, Fier, Korçë, Kukës.

Kemi vënë re se disa AdZM për disa probleme që hasin në punën e përditshme sjellin informacion pranë AKZM-së dhe e quajnë të zgjidhur problemin, duke mos propozuar zgjidhje.

Do të ishte më mirë që çdo propozim të vinte nga AdZM-të të cilët janë më në brendësi të detyrave të tyre në punën e përditshme dhe si rrjedhojë dhe ndihma jonë në zgjidhjen e problemeve do të ishte më konkrete.

Në lidhje me bashkëpunimin me instucionet e tjera shtetërore nuk është bërë aq sa duhet, gjithnjë kjo sipas informacioneve të sjella pranë sek. të monitorimit në AKZM sidomos me ISHMP-të rajonale në qarqe, ku mund të themi se në disa qarqe ka qenë inekzistent, sidomos ai i Qarkut Durrës, kjo jo për fajin e AdZM-së por për mos bashkëpunimin e inspektorëve të ISHMP rajonale.

Për këtë nga ana jonë është vënë disa herë në dijeni ISHMP qendror, por nuk është arritur ndonjë zgjidhje konkrete, ndoshta dhe nga fakti se deri tani nuk kemi ndojë dokument konkret të hartur, për të përcaktuar detyrat e detyrimet në lidhje mbi bashkëpunimin në mes dy instucioneve.

Për këtë problem nga sek. i monitorimit në AKZM është hartur një draft bashkëpunimi dhe pritet miratimi nga ana e ISHMP-së qendrore, ku është synuar që të rritet bashkëpunimi reciprok i AKZM-së dhe ISHMP-së në nivel qendror dhe rajonal.

Në bazë të të gjithave informacioneve të ardhura nga AdZM-të e qarqeve për problematikat e hasura, gjatë periudhës Mars-Dhjetor 2015 nga Sektori i Monitorimit të AKZM-së janë kryer kontrole në AdZM-të e disa qarqeve e kushtëzuar kjo nga mundësia e lëvizjes për arsye se pajisja me mjet lëvizës është bërë në Shtator 2015.

Me urdhër inspektimi të Drejtorit të Përgjithshëm Z. Zamir DEDEJ është kryer inspektim në AdZM-të e qarqeve me objekt:

1. Inspektim me grup pune mbi problematikat dhe parandalimin e prerjeve të paligjshme, gjuetisë, dëmtim të biodiversitetit dhe ushtrim aktivitetesh të paligjshme nga subjekte private brenda zonave të mbrojtura të Qarqeve
2. Inspektim mbi zbatimin e detyrave të personelit të AdZM-së

Në AdZM-në e Qarkut Tiranë

Datat, 10.09.2015, 11.11.2015, , 08.12.2015, 11.12.2015, 15.12.2015

Në AdZM-në e Qarkut Dibër

Datat 10.11.2015, 15.12.2015, 24.12.2015

Në AdZM-në e Qarkut Elbasan

Datat 05.11.2015, 10.12.2015.

Në AdZM-në e Qarkut Fier

Data 08.09.2015.

Në AdZM-në e Qarkut Shkodër

Data 03.11.2015.

Në AdZM-në e Qarkut Durrës

Datat 04.11.2015. 06.12.2015

Në AdZM-në e Qarkut Berat

Data 12.11.2015.

Në AdZM-në e Qarkut Gjirokastrë

Data, 14.11.2015

Në AdZM-në e Qarkut Kukës

Data 25.11.2015.

Në AdZM-në e Qarkut Lezhë

Data 20.11.2015

Gjatë inspektimit u konstatua se:

1. Personeli i AdZM-së u gjend në punë dhe në përgjithsi ishin të informuar me detyrat që duhet të kryenin.
 - a. Në AdZM-të e qarqeve Gjirokastrë, Berat dhe Dibër disa punonjës nuk u gjendën në vendin e punës, për këto persona u morën masa disiplinore.
2. U konstatuan se brenda ZM janë prerë pemë pyjore ku ishin mbajtur proces-verbalet e konstatimit nga rojet mjedisore dhe ishte njoftuar ISHMP-ja

3. Në AdZM-në Tiranë, PK “Mali i Dajtit” subjekti “Gjoka SHPK” kryente punime gërmime për shtrirjen e tubacionit të ujit të pishëm duke mos paraqitur lejen përkatse për këto punime.
Menjëherë u morën masat e bllokimit të punimeve dhe hartimi i proces-verbalit të konstatimit dhe u bë njoftimi i ISHMP-së Rajonale dhe Qendrori.
4. Në AdZM-në e Qarkut Dibër gjatë inspektimit në terren në datë 15.12.2015 u kap në flagrancë nga grupi i punës, duke prerë pemë pyjore shtetataasi Erion Baleta, për të cilin u mor masa e procedimit dhe u njoftua ISHMP-ja rajonale dhe qendrore. Gjithashtu u morën masa disiplinore për rojet mjedisore që mbulonoin këtë zonë.
5. Në AdZM-në e Qarkut Vlorë nga proces verbalet e ardhura në Sektorin e Monitorim në AKZM-në u konstatuan mos rakordimi i proces verbaleve të konstatimit me proces verbalet e procedimit të ISHMP-së Rajonale Vlorë, ndaj këtyre punonjësve u morën masa disiplinore.
6. Gjatë inspektimit të subjekteve private që ushtrojnë aktivitetin e tyre brenda zonave të mbrojtura në qarqe u konstatua se:
 - a. Kontratat e tyre janë lidhur me Dretoritë e Shërbimit Pyjor të qarqeve
 - b. AdZM-të e qarqeve nuk disponojnë dokumentacionin përkatës mbi këto kontrata apo aktivitete që ushyrohen brenda zonave të mbrojtura.
7. Raste të gjuetisë së paligjshme nuk janë konstatuar, megjithë kontrollet e ushtruara në disa qarqe si Shkodër, Elbasan, Fier, Tiranë jo vetëm ditën por edhe gjatë natës me grupe të përbashkëta me AdZM-të, është vënë re se ky aktivitet i paligjshëm është minimizuar në maksimum dhe si rrjedhojë e moratoriumit për gjuetinë.

Për të gjitha problematikat e konstatuara në AdZM-të e qarqeve, u lanë detyra specifike për ndjekjen dhe zgjidhjen e tyre.

III. AKTIVITETE PROMOVUESE DHE INVESTIMI NË ZONAT E MBROJTURA

3.1. Në kuadër të investimeve në zonat e mbrojtura

- Gjatë vitit 2015 janë realizuar investime në infrastrukturë nëpërmjet hapjes dhe pastrimit të 5000 m² shtigjeve tokësore (Sarandë), krijimin e 2 (dy) kalime shtigjesh nënujorë (Karaburun), zgjerimin e 3km rrugë (Syri i Kaltër), janë pastruar 3900 m² mbetje urbane (Sarandë, Butrint), është realizuar 1.5 km mur mbrojtës, janë mbjellë 1000 fidanë (Elbasan) duke zbutur ndikimet negative të shkallës së erozionit në zonë, ka përfunduar hartëzimi i 40 Km shtigje (Gjiri i Gramës, Pashaliman-Shën Vasil, Llogara), janë ndërtuar 2 (parkingje) dhe 1 urë për kmëbësorë, janë ngritur 3 cesma turistike (Elbasan).

3.2. Për promovimin e vlerave natyrore, kulturore dhe tradicionale

Janë organizuar 20, festa të ndryshme tradicionale, lokale dhe me bashkëpunimin e donatorëve të ndryshëm (Dita e Geshtenjes, dita e Bjeshkës, festa e verërave Pogradec festa e luleve, dita e Parkut Kombëtar Shebenik-Jabllanicë, dita e liqenit Pogradec, etj.)

3.3. Për promovimin e zhvillimit të qëndrueshëm

Janë organizuar 18 takime/ guida turistike nga të cilat;

- 3 për ruajtjen dhe mbrojtjen e habitateve të zonës,
- 2 vjeljen dhe grumbullimin e bimëve mjekësore,
- 7 për promovimin e zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm,
- 2 për promovimin e turizmit familjar,
- 6 guidave turistike, për njohjen e llojet e veçanta floristike dhe faunistike të zonave të ndryshme

Gjatë vitit 2015 është konstatuar një rritje e numrit të turistëve vendas dhe të huaj në zonat e mbrojtura. Vetëm për periudhën Mars – Dhjetor 2015, rezulton një total i numrit të turistëve që kanë vizituar zonat e mbrojtura prej 222,155 turistë vendas dhe të huaj.

1200	turistë në Parkun Kombëtar Sehbenik-Jabllanicë,
138,691	në parkun Kombëtar të Butrintit,
13,023	turistë në Monumentin Natyror Syri i Kalter,
60.000	turistë në Parkun Kombëtar Lugina e Valbonës, 5400 turistë në Rezervatin strikt natyror Lum i Gashit,
415	turistë në Parkun Natyror Rajonal Kune –Vain-Talë,
3426	turistë në Parkun Kombëtar Dajt.

IV NGRITJA E KAPACITETEVE TË STAFIT DHE KOMUNIKIMI

Bazuar në Urdhrin e KM nr. 39, datë 12.03.2015 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës, së Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura ka në përbërje të strukturës së saj 12 Administrata Rajonale të Zonave të Mbrojtura, dhe një numër total punonjësish prej 224 (dyqind e njëzetë e katër).

4. Në përmbushje të detyrave të ngarkuara, mbështetur në Rregulloren e AKZM, administratat rajonale gjatë vitit 2015, kanë përgatitur;

4.1.1. Informacionin mujor lidhur me realizimin e detyrave bazuar në planin mujor, dhe çdo administratë është mbledhur për përgatitjen e planit të punës të muajit pasardhës.

4.1.2. Janë hartuar projekt ide, lidhur me trajtimin e pyjeve, rehabilitimin e sipërfaqeve të caktuara

4.1.3. Janë realizuar marrëveshje bashkëpunimi me universitetet dhe Drejtoritë Arsimore, Rajonale, për promovimin e vlerave natyrore të zonave të mbrojtura dhe edukimin e brezit të ri për rëndësinë e mbrojtjes së tyre.

5. Në kuadër të trajnimeve të organizuara nga projekte të ndryshme për ngritjen e kapaciteteve, stafi i administratave, ka marrë pjesë:

5.2.1. Në 33 takime/ trajnime kombëtare dhe ndërkombëtare, të organizuara nga Donatorë të ndryshëm (IUCN, Natura2000, ECRAN, GIZ, UNESCO, UNDP):

- Në fushën e monitorimit dhe administrimit të zonave të mbrojtura,
- Promovimin dhe zhvillimin e mekanizmave të qëndrueshëm financiarë, për zonat e mbrojtura
- Vlerësimin e gjendjes aktuale të Zonave të Mbrojtura nëpërmjet metodës METT

- Përgatitjen e analizës SËOT
- Menaxhimin sa më efikas të zonave të mbrojtura. etj.

5.2.2. Në kuadër të shkëmbim të eksperiencave ndërkufitare lidhur me promovimin dhe menaxhimin e vlerave dhe resurseve natyrore, janë realizuar 6 takime rajonale midis Administratave dhe organizmave, institucioneve homologe të Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë, Greqisë.

6. Në kuadër të rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional:

- Janë organizuar takime midis Administratave, komunitetit, Pushtetit vendor, Policisë së Shtetit, Policisë Kufitare dhe organizma të tjerë, me qëllim parandalimin e çdo fenomeni të kundër-ligjshëm në zonat e mbrojtura të çdo qarku.

7. Për rritjen e komunikimit dhe ndërgjegjësimit

Bazuar në shtyllën e tretë të programit strategjik të AKZM, për rritjen e komunikimit dhe ndërgjegjësimit, si dhe në kuadër të rritjes së bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërsektorial janë:

- Realizuar takime të ndryshme me banorët në lidhje me aktivitetet alternative për ruajtjen dhe mbrojtjen e habitateve të zonës
- Njëkohësisht janë organizuar 7 praktika mësimore dhe ekskursione me nxënësit e shkollave 9-vjeçarej dhe studentet, për promovimin e vlerave natyrore të zonave të mbrojtura dhe rëndësisë së llojeve floristikë dhe faunistikë të tyre.

Detyrat për të ardhmen:

- Detyrat kryesore të Sektorit të Menaxhimit për vitin 2016, dalin nga programi Mbi Strategjinë kombëtare për zonat e mbrojtura dhe konkretisht do të jenë:
- **1.** Organizimi i punës për hartimin, standartizimin dhe mbajtjen e të gjithë të dhënave nëpërmjet përdorimit të teknologjive të avancuara. (Rregjistri Kombëtar), për të gjitha aktivitetet dhe veprimtaritë që do të kryhen dhe trajtohen gjatë vitit 2016 si:
- Skedat kadastrale unifikimi i modelit të tyre, Skedat për monumentet e natyrës (MN), Rregjistër, për ndërtimet pa leje, për pikat e ndotjeve, për pikat turistike, për guroret, HEC-et, minierat, restorante dhe njesi të tjera shërbimesh që gjenden brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.
- **2.** Hartimi i programit vjetor mbi Administrimin, menaxhimin dhe kujdesin e rrjetit të zonave të mbrojtura dhe të monumenteve të natyrës.
- **3.** Organizimi i punës për gjetjen e burimeve të të ardhurave që do të rrjedhin nga zonat e mbrojtura për çdo AdZM, si kontrata për kullotat, bimët mjeksore, prodhime të dyta pyjore e jo pyjore, dhënie në përdorim të sipërfaqeve për ushtrim aktivitetesh etj, (sipas specifikave që ka çdo qark).
- **4.** Hartimi (përgatitja) e kontratave (kontrata të reja, kontrata në vazhdim trashëguar nga DRSHP-të, zgjatja e afateve të kontratave nëse ka), duke u mbështetur në bazën ligjore të ligjit “Për Zonat e Mbrojtura” dhe specifikimet teknike të aktivitetit apo veprimtarisë që do të kryhet.

- **5.** Përgatitja dhe planifikimi në çdo AdZM, e ZM-ve për inventarizimin, mbarështimin e pyjeve dhe kullotave, bimëvë mjekësore dhe të aktiviteteve të tjera që kryhen në zonat e mbrojtura.
 - **6.** Përgatitja e skedave të punës për mbledhjen dhe grumbullimin e të dhënave në terren për aktivitetet që kryhen në zonat e mbrojtura në bashkëpunim me AdZM-të.
 - **7.** Saktësimi i sipërfaqeve dhe kufijve të zonave të mbrojtura, ndarjet e zonimit të brendshëm, të habitateve dhe ekosistemeve, ndërtimi i hartave dixhitale në bashkëpunim me AdZM-të në qarqe.
 - **8.** Përgatitja e programit të punës për kryerjen e trajnimeve të stafit të AdZM-ve përzgjedhja e temave teknike për menaxhimin, kujdesin e mirëmbajtjen e rrjetit të zonave të mbrojtura, për përdorimin e sistemit GIS në formatimin e databez-ve që do të krijohen.
 - **9.** Përgatitja e programit të punës për planifikimin e masave teknike për ndërhyrje në përmirësimin dhe menaxhimin e zonave të mbrojtura.
-
- Përmirësim i punës në plotësimin e dukumentacinit teknik sidomos të proceverbaleve të konstatimit nga rojet mjedisore.
 - Marrjen e masave për administrimin më të mirë të fluksit të vizitorëve me qëllim shmangjen e mbipopullimit në disa zona.
 - Monitorimin për florën dhe faunën sipas metodikave standarte.
 - Kryerje e studimeve e hartimin e projekteve për rehabilitimin sipërfaqeve pyjore të dëmtuara rënda ZM dhe masave antierozive.
 - Hartimi dhe lidhja e kontratave me përdoruesit e kullotave, bimëve mjekësore etj.
 - Përmirësimi i punës dhe rritja e bashkëpunimit me ISHMP dhe njësitë e qeverisjes vendore
 - Përgatitja e materialeve informuese e promovuese për ZM.
 - Identifikimi i aktoreve kryesore në zonat e mbrojtura që ndikojnë në menaxhimin e burimeve;
 - Organizimi i festave lokale dhe ditët e shënuara mjedisore për të promovuar zonat e mbrojtura.
 - Organizimi i aktiviteteve sensibilizuese e edukuese me nxënësit e shkollave.
 - Organizimi i vizitave të shkëmbimit të eksperiencave pozitive në punë.
 - Forcimi i kontrollit të territorit në të ZM dhe evidentimi e denoncimi në kohë i ndërhyrjeve të paligjshme në fondin pyjor dhe kullësore.
 - Bashkëpunimi me projektin Natyra 2000 për ngritjen e kapaciteteve monitorimet e pasisjen me bazë materilaoteknike.
 - Rritja e shkallës së bashkëpunimit dhe koordinimit me të gjithë aktorët lokalë në dobi të forcimit të punës për menaxhimin dhe zhvillimin e ZM.